



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



Datë: 22.10.2014

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 21.10.2014, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 572, të datës 29.09.2014, paraqitur nga Drejtoria për Financa, Buxhet dhe Pronë, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në Nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b dhe c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008) dhe Nenin 27, shkronja (c dhe ç), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012. mori:

V E N D I M

1. Për rritjen e të hyrave vetiake për vitin fiskal 2014, në shumë totale prej 425,000.00€, të shpërndara nëpër kategoritë ekonomike buxhetore, kodet e programeve dhe kodet e projekteve si vijon:
 - 1.1 Mjetet financiare, në shumë prej 85,000.00€, lejohen për realizimin e projektit kapital 'Bashkëfinancimi i Projekteve' 89168, në kodin ekonomik 30, programi Buxhet e Financa 17502, për realizimin e Memorandumit të Mirëkuptimit me UNDP-në;
 - 1.2 Mjetet financiare, në shumë prej 235,000.00€, lejohen për shpenzim në mallra dhe shërbime, programi 'Infrastruktura Publike 18162', në kodin ekonomik 13, për pagesën e qirasë për objektin në shfrytëzim për Administratën e Komunës dhe faturave për furnizime;
 - 1.3 Mjetet financiare, në shumë prej 10,000.00€, lejohen për shpenzim në mallra dhe shërbime, programi 'Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale 73011', në kodin ekonomik 13, për furnizim me medikamente në shëndetësi;
 - 1.4 Mjetet financiare, në shumë prej 15,000.00€, lejohen për shpenzim në subvencione, programi i Zyrës së Kryetarit 16002, kodi ekonomik 20;
 - 1.5 Mjetet financiare, në shumë prej 30,000.00€, lejohen për shpenzim në transfere, programi 'Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale 73011', kodi ekonomik 20;
 - 1.6 Mjetet financiare, në shumë prej 20,000.00€, lejohen për shpenzim në transfere, programi 'Arsim dhe Shkencë 92010', kodi ekonomik 20;
 - 1.7 Mjetet financiare, në shumë prej 20,000.00€, lejohen për shpenzim në subvencione, programi 'Kulturë, Rini dhe Sport 85002', kodi ekonomik 20 dhe
 - 1.8 Mjetet financiare, në shumë prej 10,000.00€, lejohen për shpenzim në subvencione, programi 'Buxhet dhe Financa 17502', kodi ekonomik 20.

2. Mjetet financiare nga pika 1.4, 1.5, 1.6, 1.7 dhe 1.8 e këtij vendimi lejohet të shpenzohen për ndihmë personave fizikë për shërim dhe terapi shëndetësore, studentëve, klubeve sportive, trajnime, shpenzimeve për varrim dhe ndihmë në projekte me interes të përgjithshëm Organizatave Joqeveritare.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë për Financa, Buxhet dhe Pronë.
4. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë për FBP, Drejtorisë për Arsim, Drejtorisë për SHMS, Drejtorisë për KRS, Drejtorisë për SHPM dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi

